

C.nr.254/15

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil ,si gjykatë e shkallës së parë kontestimore ,gjyqtari Burim Emërllahu, në lëndën kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë , të cilën me autorizim e përfaqëson [REDACTED] kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj Rr.' [REDACTED] ",tani me adresë të panjohur te vendbanimit të cilin në cilësin e përfaqësuesit të përkohshëm e përfaqëson avokati [REDACTED] , nga Ferizaji ,lidhur me çështjen e kontestit rimbursim dëmi pas mbajtjes së seancës kryesore,me datë 26.11.2018 ,mori këtë:

### A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadi e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i padituri [REDACTED] nga Ferizaj, që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit në Prishtinë t'ia paguaj shumën e të hollave prej 1314 euro me kamatë të cilën bankat e paguajnë për mjetet e deponuara monetare në afat prej një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e ushtrimit të padis e deri në pagesën definitive.

II.Detyrohet i padituri [REDACTED] ,që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë,në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore për taksën për padi t'ia paguaj shumën e të hollave prej 20 euro.

### A r s y e t i m

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit,nga Prishtina, ka parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj Rr.' [REDACTED] ', tani me adresë të panjohur te vendbanimit me bazë juridike rimbursimi i dëmit.

Paditësja në kërkespadi ka kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurin [REDACTED] , që paditëses t'ia paguaj shumën e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për taks për padi.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit avokati [REDACTED] ka theksuar:i propozojmë gjykatës që kërkesëpadi e paditësit për të gjitha bazat të refuzohet si e pabazuar ,ngase me provat e propozuar në padi nuk vërtetohet bazueshmëria e kërkesëpadis.

Me qëllim të vlerësimit të sa më të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje civilo juridike, gjat shqyrtimit gjyqësorë janë administruar si provë: shkresa me emërtimin dosja e dëmit nr. 1254/12 e lëshuar nga Byroja Kosovare e Sigurimit, Urdhër transferi i datës 27.09.2012, i lëshuar nga paditësja, Ujdia jashtë gjyqësore me numër

1254/12 e dt. 21.09.2012, vendimi i datës 18.09.2012, i lëshuar nga paditësja me numër FK-1254/2012 i dt. 18.09.2012, vendimi i nxjerrur nga Komisioni [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], komision ky i paditëses, shkresa mbi kalkulimin e dëmit me numër të lëndës 1254/12 i hartuar nga paditësja, gjegjësisht eksperti i saj [REDAKTUAR], ankesa e datës 13.09.2012 e ushtruar nga avokati [REDAKTUAR], kundër vendimit të paditëses, vendimi i datës 07.09.2012 nr.FK1254/2012 i lëshuar nga paditësja, kërkesa për kompensim dëmi e datës 17.08.2012, e parashtruar te paditësja, nga avokati [REDAKTUAR], vendimi i Komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit i dt. 21.08.2012 nr.1254/12, autorizimi vitit 2012, shkresa mbi kalkulimin e dëmit e datës 28.07.2012 e lëshuar nga BKS-ja. , kopja e librezës së qarkullimit në emër të [REDAKTUAR] me numër 0208323, konfirmimi i sigurimit i datës 17.08.2012, raporti policor i datës 13.08.2012, shikimi në 10 faqe foto, urdhër tranferi i pranuar nga Banka ekonomike, ekspertiza e ekspertit të komunikacionit [REDAKTUAR]

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara ,deklaratave të palëve ndërgjyqëse vërtetoi këtë gjendje faktike : Me leximin e raporti policor të aksidentit nr. CFT 1770 i datës 13.08.2012, gjykata ka vërtetuar se me datën 13.08.2012, në rrugën "Ismet Ramadani" ka ndodhur një aksident i komunikacionit rrugor në të cilin si pjesëmarrës ishte atomjeti i markës 'BMW ,tipi SE AUTO, me targa [REDAKTUAR] të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte i padituri [REDAKTUAR] dhe automjeti: lloji Rend Kango, marka Pikap ,tipi transp, me targa [REDAKTUAR], të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte [REDAKTUAR], kurse si pasojë e këtij aksidenti dëm materiale ishin shkaktuar në veturën e sipër përmendur lloji Rend Kango, marka Pikap ,tipi transp, me targa [REDAKTUAR], me pronarë [REDAKTUAR]

Me leximin e ekspertizës së komunikacionit e hartuar nga eksperti e komunikacionit [REDAKTUAR] e datës 13.11.2018 gjykata ka vërtetuar se shkaktar i aksidentit të sipër përmendur ishte tani i padituri [REDAKTUAR], të cilin e kishte shkaktuar me automjetin e sipër përmendur 'BMW ,tipi SE AUTO, me targa [REDAKTUAR].

Me leçimin e provave : Urdhër tranferi i datës 27.09.2012, i lëshuar nga paditësja, Ujdia jashtë gjyqësore me numër 1254/12 e dt. 21.09.2012, vendimi i datës 18.09.2012, i lëshuar nga paditësja me numër FK-1254/2012 i dt. 18.09.2012, vendimi i nxjerrur nga Komisioni [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], komision ky i paditëses, shkresa mbi kalkulimin e dëmit me numër të lëndës 1254/12 i hartuar nga paditësja, urdhër tranferi i pranuar nga Banka ekonomike, gjykata ka vërtetuar se tani paditësja i'a kishte paguar edhe shumën e të hollave prej 1314 euro të dëmtuarit të sipër përmendur [REDAKTUAR] në emër të kompenzimit të dëmit, që kishin pësuar në aksidentin në fjalë të datës 13.08.2012.

Po ashtu gjykata me leximin e raportit policor të sipër përmendur ka konstatuar se automjeti i sipër përmendur 'BMW ,tipi SE AUTO, me targa [REDAKTUAR], me të cilin është shkaktuar aksidenti i sipër përmendur nuk ka qenë i siguruar në ndonjë kompani të sigurimeve për ti mbuluar dëmet qe mund ti shkaktoj ne Kosovë.


Andaj gjykata bazuar në gjendjen faktike të shpjeguar si më lartë, ka ardhur në përfundim, se kërkespadija e paditëses është e bazuar edhe atë nga këto arsye: nga provat e administruara u vërtetua, se me të vërtetë me datë 13.08.2012 ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, të cilin e ka shkaktuar i padituri me 'BMW', tipi SE AUTO, me targa [REDAKTUAR], të cilin nuk e ka pasur të siguruar për të mbuluar dëmet që mund të shkaktojnë në Kosovë dhe se i padituri ka qenë fajtor për shkaktimin e atij aksidenti të sipër përmendur, dhe se si pasojë e aksidentit të përmendur i dëmtuari [REDAKTUAR] ka pësuar dëm, të cilin dëm paditësja ia ka kompenzuar duke u' paguar edhe shumën prej 1314 €, kurse i padituri ka detyrim që shumën sipër përmendur prej 1314 €, t'ia kompenzojë gjegjësishtë paguaj paditëses, duke u bazuar edhe në nenin 18 paragrafi 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është bazuar në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Më datë 26.11.2018

Gjyqtari  
Burim Emërllahu



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOŠI

VENDIMI ËSHTË I PLOTËDISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOŠENNA  
GJYKATA THEMELORE / OSMOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më 24.12 20 18  
Dana

